



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. 10934/12 Prot.

Tiranë, më 02.12.2016

URDHËR

Nr. 565, datë 02 / 12 / 2016

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, “MASTER I SHKENCAVE” NË “INXHINIERI KOMPJUTERIKE DHE TEKNOLOGJI INFORMACIONI”, ME PROFILE: “INXHINIERI KOMPJUTERIKE DHE BIG DATA”; “RRJETET KOMPJUTERIKE DHE SIGURIA KIBERNETIKE”; “MULTIMEDIA – DIZAJN” TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”, TIRANË

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 35 të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, “Master i Shkencave” në “Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni”, me profile: “Inxhinieri kompjuterike dhe Big Data”; “Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike”; “Multimedia – Dizajn në Fakultetin e Inxhinierisë, të ShLUP “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Tiranë, që realizohet me 120 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, në gjuhë angleze, me kohëzgjatje 2 vite / 4 semestra, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë universitare “Master i Shkencave” në “Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni”, me profilet përkatëse.
2. Ky program studimi hapet, në bazë të Vendimit nr. 194, datë 17.10.2016, të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.
3. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror për Arsimin dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Shkolla e Lartë Universitare Private “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, Tiranë.

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.*

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

